



Lënda : Informacion per realizimin e treguesve ekonomiko-financiarë gjate 6 mujorit te pare te vitit 2020.

Drejtuar : **KESHILLIT DREJTUES TE RTSH**

**Zotit Thoma GËLLÇI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I RTSH**

Ne mbledhjen e dates 23 korrik 2020, Bordi i Administrimit te Radiotelevizionit Shqiptar (RTSH) analizoi rezultatet ekonomike dhe financiare per 6 mujorin e pare për vitin 2020, te cilat paraqiten ne vijim:

A.Realizimi i të ardhurave në krahasim me parashikimin gjatë 6/Mujorit të parë të vitit 2020 :

Në 000/lekë

Nr	Emertimi	Parashikimi Viti 2020	Parashik. 6/muj.I Viti 2020	Realizimi 6/muj.I Viti 2020	Real. ne %
I.	Financimi nga buxheti	634,000	340,550	340,550	100
	Bashkatdhetarët&Sateliti	270,000	160,000	160,000	100
	Projekte Filmike&Artistike	60,000	-	-	
	Orkestra Simfonike RTSH	54,000	30,000	30,000	100
	Shërbim mirëmbajtje rrjeti digjitaliz.,etj	180,000	120,000	120,000	100
	Investime në Teknologji	70,000	30,550	30,550	100
II.	Të ardhura nga tarifa aparatit TV.	1,420,000	710,000	601,000	85
III.	Të ardhura te institucionit	346,000	140,000	99,300	71
	Sherbim ambjente transmetuese,tr.fm	150,000	80,000	66,300	83
	Reklama,njoftime etj.	150,000	50,000	25,000	50
	Të ardhura të tjera	46,000	10,000	8,000	80
	TOTALI	2,400,000	1,190,550	1,040,850	87,4

Të ardhurat janë realizuar në masën 87,4 % në krahasim me planifikimin ose me një mosrealizim në vlerë absolute prej 149,7 milion lekë.





1-Të ardhurat nga buxheti janë realizuar në masën 100%. Financimi buxhetor i tërhequr si gjashtëmujor përbën 54% ndaj totalit të planifikimit vjetor.

Realizimi i financimit nuk ka hasur në problematika, megjithëse vlerat e mbetura për zërat e financimit nuk mbulojnë shpenzimet e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2020. Konkretisht për zërat e orkestrës simfonike, Shërbimit të mirëmbajtjes së rrjetit, vlerat e financimit nga buxheti i shtetit, mbulojnë një pjesë të këtyre shpenzimeve. Pjesa e mbetur do të mbulohet nga të ardhurat e veta të RTSH.

Në proces për t'u realizuar deri në fund të vitit mbeten vlerat e Projekteve filmike, artistike dhe Shpenzimet për investime në teknologji.

2.E ardhura nga tarifa e përdorimit të aparatit marrës televiziv është realizuar në masën 85%, me një mosrealizim ndaj parashikimit për 109 milion lekë. Gjatë muajve janar e shkurt niveli i arketimeve ka qenë mbi 110 milion lekë, në muajt mars dhe prill ka qenë në nivelin e 98 milion lekë, në muajin maj zbriti në nivelin 80 milion lekë dhe në muajin qershor paraqitet në vlerën 103,8 milion lekë.

Nëse arkëtimi vijon në të njëjtin ritëm, mosrealizimi vjetor nga kjo e ardhur në buxhetin e RTSH në vitin 2020, parashikohet në rreth 220 milion lekë.

3.Të ardhurat e veta të RTSH paraqiten të realizuara në masën 71%, ose me një mosrealizim në vlerë absolute për 40,7 milion lekë.

a.Të ardhurat nga shërbimi në ambientet transmetuese të RTSH dhe transmetime fm janë realizuar në masën ~83% ose me një mungesë në vlerë absolute 13,7 milion lekë.

Risku i realizimit në periudhën në vijim të këtij zëri vijon të parashikohet në një mosrealizim në vlerën rreth 40 milion lekë, që vjen kryesisht ngashtyrja vazhdimisht e fikjes së transmetimeve analoge, parashikuar të ndodhte në mars të vitit 2020, shtyrë përsëri deri në muajin shtator 2020, si edhe ndërprerjes së shërbimit të disa subjekteve, të cilët po ndiqen në rrugë gjyqësore.

b.Në zërin e reklamave, njoftimeve etj, gjatë kësaj periudhe ka një realizim në masën 50%, ose një mosrealizim për 25 milion lekë. Risku i realizimit të të ardhurave të këtij zëri në kufijte e planifikimit paraqitet tepër i lartë, si rezultat i situatës së pandemisë. Arsyeja kryesore lidhet me anulimin e aktiviteteve sportive dhe artistike të rëndësishme parashikuar të transmetoheshin gjatë vitit 2020.

Për vitin 2020, parashikohet që të ardhurat në këtë zë, të realizohen 60 milionë lekë, ndaj 150 milionë lekë që është parashikimi vjetor.

c.Në zërin e të ardhurave të tjera realizimi është në masën 80%. Në këtë zë janë përfshirë të ardhurat nga klikimet e kanaleve të RTSH në youtube, shitja e materialeve arkivore. **Realizimi i këtij zëri parashikuar me shtesë si rezultat i eventeve sportive të rëndësishme gjithashtu riskohet të jetë në nivelin e planifikuar dhe mosrealizimi parashikohet për 10 milion lekë.**

Në përfundim risku i realizimit të të ardhurave të buxhetit të RTSH-se për vitin 2020, mbështetur në të ardhurat gjashtëmujore, është në vlerën totale 360 milion lekë.

B.Gjatë vitit 2020 janë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme detyrimet e të tretëve ndaj RTSH-së, në mënyrë të vecantë për subjektet që mbartin detyrime të viteve 2018, 2019. Ndërsa është krijuar një situatë më e vështirë e arkëtitimit të detyrimit në afat gjatë





muajve prill dhe maj 2020,mbartur edhe gjatë muajit qershor ,si rezultat i situatës së gjendjes së pandemise.

-Detyrimet e pritshme të arkëtohen nga të tretët , jane per 14 subjekte ne shumen 12,6 milione leke.

Gjithashtu kanë detyrime për reklama, njoftime,te transmetuara në RTSh, 18 subjekte në vlerën 18,2 milione lekë.

-Në përmbarrim për ekzekutim janë 9 subjekte në shumën gjithsej të detyrimit 3,7 milionë lekë, ndërsa po ndiqet rruga gjyqesore për 10 subjekte, me vlerë gjithsej të detyrimit për 17,1 milione lekë.

-Mbeten ende për t'u përfunduar kontratat e shkëmbimit në natyrë për 9 subjekte, me vlerë totale 9,3 milion lekë.

C.Realizimi i të ardhurave krahasuar me vitin e kaluar :

Në 000/lekë

Nr	Emertimi	Realizimi 6/muj.I Viti 2019	Realizimi 6/muj.I Viti 2020
I.	Financimi nga buxheti	341,406	340,550
	Bashkatdhetarët&Sateliti	149,600	160,000
	Projekte Filmike&Artistike	12,000	-
	Orkestra Simfonike RTSH	38,400	30,000
	Shërbim mirëmbajtje rrjeti digjitaliz.,etj	120,000	120,000
	Investime në Teknologji	21,406	30,550
II.	Të ardhura nga tarifa aparatit TV.	627,721	601,000
III.	Të ardhura te institucionit	146,716	99,300
	Sherbim ambjente transmetuese,tr.fm	32,951	66,300
	Reklama,njoftime etj.	26,765	25,000
	Të ardhura të tjera (RT Kines, etj)	87,000	8,000
	TOTALI	1,115,843	1,040,850





D.Realizimi i shpenzimeve në krahasim me planifikimin gjatë 6/mujorit të parë 2020
në 000/lekë

Nr	Emertimi	Parashik. Viti 2020	Parashik. 6/muj.I Viti 2020	Realizimi 6/muj.I Viti 2020	Realizimi %
1	Paga,shpërblime ,sig.shoqëror	827,000	395,803	389,738	98
2	Materiale,lende djegese	71,300	24,927	19,804	79
3	Projekte film.,artistike ,bl.dr.tv,fondi prodhimit te pavarur	314,000	182,069	160,754	88
4	Organizma Nderkombetar	87,000	47,500	46,635	98
5	Shërbime nga të trete	280,000	146,209	133,322	91
6	Shpenzime udhëtimi e dieta	82,700	38,547	33,933	88
7	Shpenzime të tjera operative	63,000	34,287	33,695	98
8	Investime dhe miremb. rrjeti digj.	245,000	177,500	164,339	93
9	Shpenz.këste e interesa kredie	320,000	167,000	940	0.6
	TOTALI	2,400,000	1,213,842	983,160	81

Realizimi i shpenzimeve si gjashtëmujor është në nivelin 81%,ose me një mosrealizim prej 230,7 milione lekë.

Në mënyrë analitike paraqesim realizimin e zërave të shpenzimeve :

***Zëri Paga, sigurime shoqërore e shpërblime** është realizuar në masën 98% .Cdo ndryshim strukturor është duke u ndjekur paraprakisht edhe me efektin në vlerë që do të sjellë në fondin e pagave. Në total fondin e pagave , sigurimeve shoqërore e mbikohës është brenda parashikimit si periudhë gjashtëmujore, me një realizim në masën 47% kundrejt fondit të parashikuar vjetor.

***Zëri Materiale :** Realizimi i këtij zëri është në masën 79%, si rezultat edhe i situatës së vështirë financiare në të cilën u ndodh RTSh gjatë kësaj periudhe ; ose në masën 28% realizim kundrejt planifikimit vjetor.

***Zëri i Projekteve Filmike dhe Artistike dhe blerjet e të drejtave tv e të transmetimit ,** përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e të drejtave të transmetimit, dokumentarë, filma, programe sportive, artistike, shpenzimet për projektet e miratuara. Realizimi në total i këtij zëri është në masën ~88%,ose në masën 51% ndaj planifikimit vjetor. Diferenca vjen si rezultat i mosrealizimit të Eurosong parashikuar në vlerën 15 milion lekë dhe Fondin e prodhimit të pavarur.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar :

a)Blerje të drejta tv e transmetimi në vlerën 115 milion lekë nga 170 milion lekë deri në fund të vitit 2020

-aktivitete sportive(104 milion lekë)

-të drejta transmetimi tv,filma etj.(11 milion lekë)

b)Projekte filmike, artistike, bashkëprodhime me të tretë realizuar në vlerën ~46 milion lekë nga 134 milion lekë që është parashikimi vjetor.





Nga kjo vlerë, shuma 60 milion lekë është parashikuar nga financimi buxhetor (50 milion lekë për aktivitetet artistike me rendesi mbarëkombëtare dhe 10 milion lekë për realizimin e serialit televiziv).

c) Vlera 10 milion leke nga Fondi i Prodhimit te pavarur mbetet te realizohet gjate periudhes ne vijim.

***Zëri i Organizmave Ndërkombëtarë** ka mbuluar të gjitha shpenzimet që RTSH bën ndaj organizmave ndërkombëtare, si Eutelsat, Ses Astra, për shërbimin satelitor, EBU për pagesat për transmetime në radio, televizion, lajme, të drejta transmetimi të programeve e aktiviteteve të ndryshme artistike dhe sportive dhe pagesat e pjesëmarrjes. Realizimi i këtij zëri gjatë kësaj periudhe është në masën 98%, ose 54% ndaj totalit vjetor të parashikuar.

*** Zëri i Shërbimeve nga të tretë** përfshin shpenzimet për shërbime të një natyre të përgjithshme që kryhen nga të tretet për funksionimin e përditshëm të veprimtarisë së RTSH si :

- shpenzimet për energji elektrike, ujë ~ 46 milion lekë
- shpenzimet telefonike ,interneti, fibra optike ~ 12 milion lekë
- shpenzimet për ruajtjen e sigurisë fizike të objekteve të RTSH ~20 milion lekë
- qera të ambjenteve ~ 8 milion lekë
- të drejta autori ~ 7 milion lekë
- sigurime të makinave dhe shëndetit të punonjësve me kontrata shkëmbimi ~ 18 milion lekë
- pagesa ndaj Akep për frekuencat tv ~ 14 milion lekë
- shpenzime të tjera prurësi reklame, kosto transmetimi, riparim shërbime etj. ~ 8 milion lekë

Realizimi i këtij zëri është në nivelin 91% , ose 48% ndaj totalit të planifikuar vjetor.

***Zëri i shpenzimeve Udhëtim e dieta** është realizuar në nivelin 88% si gjashtëmuor, dhe 41% kundrejt totalit vjetor të planifikimit, për arsye të kufizimit të levizjeve vecanerisht jashtë vendit.

***Zëri i shpenzimeve të tjera Operative** është realizuar në nivelin 98 % si gjashtëmuor dhe 53% ndaj totalit vjetor të parashikuar. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për pritje e percjellje në Drejtorinë e Përgjithshme, shpenzimet për honorare në të gjitha drejtoritë e sistemit si edhe shpenzimet për taksa,tatime etj. Zëri Honorare mbetet të ndiqet me vëmendje në periudhën në vijim, që mos të tejkalojë limitet e planifikuara.

***Zëri i shpenzimeve për Investime dhe shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit** është realizuar në nivelin 93%.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesat për shpenzime të mirëmbajtjes së rrjetit për periudhën tetor-dhjetor 2019 dhe janar-mars 2020.

Në zërin Investime janë levruar pjesërisht kontrata e investimit RTSH Agro në vlerën 30,5 milionë lekë si edhe diferenca të procedurave të investimeve mbartur nga viti 2019.

***Zëri i shpenzimeve për keste e interesa kredie.** Gjatë kësaj periudhe janë likuiduar detyrimet e fee të kontratës së huasë , ndërsa si rezultat i mungesës së të ardhurave në momentin e pagesës së kredisë , pagesa e planifikuar në muajin mars 2020 u krye nga Ministria e Financave si garantues i kredisë.





Me mosrealizimet e të ardhurave të 6 mujorit të parë, por dhe të ardhurat e pritshme për periudhën në vijim, parashikohet që edhe pagesa e dytë e kështit të kredisë të mos paguhet nga RTSH.

Realizimi i shpenzimeve krahasuar me vitin e kaluar.

Ne 000 leke

Nr	Emertimi	Realizimi 6/muj.I Viti 2019	Realizimi 6/muj.I Viti 2020
1	Paga,shpërblime ,sig.shoqeror	390,992	389,738
2	Materiale,lende djegese	33,819	19,804
3	Projekte film.,artistike ,bl.dr.tv,f.p.pav. etj	227,214	160,754
4	Organizma Nderkombetar	58,010	46,635
5	Shërbime nga të trete	112,144	133,322
6	Shpenzime udhëtimi e dieta	34,835	33,933
7	Shpenzime të tjera operative	33,266	33,695
8	Investime dhe miremb. rrjeti digj.	167,255	164,339
9	Shpenz.këste e interesa kredie	547	940
	TOTALI	1,058,082	983,160

Në mënyrë të përmbledhur , duke analizuar situatën e deritanishme të të ardhurave dhe shpenzimeve , risku i realizimit të buxhetit të RTSh gjatë këtij viti paraqitet tepër i lartë.

